



Funded by
the European Union



NATURA 2000

NË KOMPLEKSIN NATYROR NARTË-PISHË-PORO



PPNEA

Protection and Preservation of Natural Interests in Albania

euRONATUR



NATURA 2000: RRJETI EVROPIAN I ZONAVE TË MBROJTURA

Natura 2000 është rrjeti më i madh i koordinuar i zonave të mbrojtura në të gjithë botën. Nëpërmjet këtij rrjeti, Bashkimi Evropian ruan zona ku lloje të rrallë e të kërcënuar jetojnë dhe riprodhohen, duke mos përjashtuar habitate natyrore të rëndësishme, si tokësore ashtu edhe ujore. Krijimi, mirëfunksionimi dhe zgjerimi i rrjetit Natura 2000 ka si qëllim sigurimin e mbijetesës afatgjatë të llojeve dhe habitateve të rrezikuar, duke ruajtur vlerat e biodiversitetit përgjatë kontinentit evropian.

Si pjesë e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, vendet candidate duhet të paraqesin propozime për zona të cilat i plotësojnë kushtet për tu përfshirë në rrjetin Natura 2000.



HAPJA E RRUGËS DREJT NJË RRJETI TË QËNDRUESHËM NATURA 2000 NË SHQIPËRI: RASTI I KOMPLEKSIT NARTË - PISHË - PORO

Ky projekt i implementuar nga PPNEA, organizata e parë mjedisore në Shqipëri, promovon zhvillimin e qëndrueshëm në kompleksin natyror Nartë-Pishë-Poro dhe ruajtjen afatgjatë të vlerave të biodiversitetit për brezat e tanishëm e ata që do të vijnë. Kompleksi Nartë-Pishë-Poro është një zonë tejet e rëndësishme ku gjenden lloje të rrezikuar të jetës së egër dhe habitate me rëndësi ndërkombëtare, duke përmbushur më së miri kriteret e përfshirjes në rrjetin Natura 2000. Për këtë arsye, ekipi i PPNEA, së bashku me ekspertë kombëtar të trajnuar, kanë ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

Analizimi i vlerave natyrore të zonës

- Identifikimi i habitateve dhe llojeve me interes ruajtje;
- Identifikimi i komuniteteve bimore me interes ruajtje dhe shpërndarjes së tyre.

Analizimi i marrëdhënieve midis vlerave natyrore dhe bashkësive lokale

- Identifikimi i shërbimeve të ekosistemit;
- Identifikimi i presioneve dhe kërcënimeve;
- Identifikimi i palëve të interesit dhe zgjidhja e konflikteve.





KOMPLEKSI NATYROR NARTË-PISHË-PORO

Kompleksi Natyror Nartë-Pishë-Poro përbëhet nga Peizazhi i Mbrojtur Vjosë-Nartë dhe Rezervati Natyror i Menaxhuar Pishë-Poro. Peizazhi i Mbrojtur Vjosë-Nartë renditet nga Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës si Zonë e Rëndësishme për Shpendët (IBA) dhe si Zonë e Rëndësishme për Bimët (IPA). Për këtë arsye, zbatimi i projektit në këtë zonë ka ndihmuar në implementimin e dy direktivave kryesore të Natura 2000, si Direktiva e Habitave dhe Direktiva e Shpendëve. Peizazhi i Mbrojtur Vjosë-Nartë strehon një larmishmëri llojesh të florës dhe faunës, duke përfshirë një mori habitata të ndryshme si pyje me pisha, lumenj, ligatina me ujë të ëmbël, kënetë, shkurre apo edhe duna ranore. Gjithashtu, Rezervati Natyror i Menaxhuar Pishë-Poro është një prej grykëderdhjeve më të rëndësishme në vend. Bimësia e rezervatit është e përbërë nga grupe tipike të ligatinave detare, si dhe pyje mesdhetare me pisha.



GJITARËT

Peizazhi i Mbrojtur Vjosë-Nartë, Kategoria V sipas Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës, përmban habitate ujore të rëndësishme të cilat i sigurojnë lundërzës (*Lutra lutra*) dhe gjitarëve të tjerë si çakallit (*Canis aureus*), dhelpërës (*Vulpes vulpes*), lepurit të egër (*Lepus europaeus*), kunadhes (*Martes foina*) dhe baldosës (*Meles meles*), kushte specifike për t'u strehuar, riprodhuar dhe ushqyer në këtë zonë. Përcaktimi i zonave kandidate për rrjetin natyra 2000 në lidhje me gjitarët është fokusuar rreth lundërzës, e cila gëzon një interes të lartë ruajtje në nivel kombëtar e ndërkombëtar, e listuar në listën e kuqe të florës dhe faunës në Shqipëri, si dhe në aneksin II dhe IV të Direktivës së Habitave. Gjithashtu, prania e këtij gjitari mishngrënës i familjes Mustelidae, vlerësohet edhe si një "indikator" i cilësisë së mirë të një habitati ujor.





SHPENDËT

Kompleksi natyror Nartë-Pishë Poro është pjesë e rrjetit të ligatinave bregdetare shqiptare, të cilat janë pjesë e pazëvendësueshme e rrugës së shtegtimimit të Adriatikut lindor. Duke qenë se popullatat e shpendëve shtegtarë dhe ato me status ruajtjeje janë të ndjeshëm ndaj ndryshimeve në ekosistem dhe në habitatet të cilat përdorin, vendet anëtare të Bashkimit Evropian krijuan Direktivën e Shpendëve, e cila pas amendimit në vitin 2009 njihet si Direktiva 2009/147/EC për ruajtjen e Shpendëve të Egër.

Nga mbi 200 lloje shpendësh të regjistruar në këtë ekosistem, 62 prej tyre janë pjesë e Shtojcës I të Direktivës së Shpendëve, e cila detyron vendet anëtare dhe vendet që kanë nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me Bashkimin Evropian, të shpallin Zona të Posaçme Mbrojtje (SPA) për këto lloje. Për më tepër, 33 lloje janë të listuar me status kërcënimi në Listën e Kuqe të Shqipërisë.

Në këtë kompleks natyror gjenden mbi 1% e popullatave të llojeve të rajonit të Mesdheut dhe Detit të Zi, si p.sh. sqepbiza (*Recurvirostra avosetta*), pelikani kaçurrel (*Pelecanus crispus*) dhe flamingo (*Phoenicopterus roseus*).



AMFIBËT DHE REPTILËT

Në Peizazhin e Mbrojtur Vjosë-Nartë gjenden rreth 8 lloje amfibësh nga 16 që njihen në të gjithë Shqipërinë. Midis këtyre 8 llojeve renditet edhe bretkosa endemike shqiptare (*Pelophylax shqipericus*), e cila gëzon një interes të lartë ruajtjeje për shkak të popullatës së vogël, duke u klasifikuar si e Rrezikuar (EN) nga Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës. Bretkosa endemike e Shqipërisë mbrohet edhe nga konventa e Bernës, ku gjendet e listuar në aneksin III.

Reptilët e zonës së mbrojtur Vjosë - Nartë janë të shumtë, por vlen të përmendim praninë e llojeve të breshkave (të tokës dhe ujërave të ëmbla), si breshka e tokës (*Testudo hermanni*), breshka e ujit (*Emys orbicularis*), breshkujza (*Mauremys rivulata*), të cilat janë lloje me interes ruajtjeje, pjesë e aneksit II dhe IV të Direktivës Evropiane të Habiteteve.

Gjithashtu, ndër llojet e gjarpërinjve, familja Colubridae, veçojmë praninë e bollës me katër vija (*Elaphe quatuorlineata*), e cila po ashtu është pjesë e aneksit II dhe IV të Direktivës Evropiane të Habiteteve.



BOTA BIMORE

Në kompleksin natyror Nartë-Pishë-Poro hasen rreth 18 habitate të listuar në Direktivën Evropiane të Habitaveve, 4 prej të cilave cilësohen si habitate prioritare:

1150 - Laguna bregdetare;

1510 - Stepa të kripura mesdhetare (*Limonetalia*);

2250 - Duna bregdetare me dëllinjë (*Juniperus ssp.*);

2270 - Duna të pyllëzuara me pisha të buta (*Pinus pinea*) dhe/ose pisha të detit (*Pinus pinaster*).

Habitatet prioritare quhen ato habitate të cilat rrezikojnë që të zhduken. Për këtë arsye, edhe përgjegjësia për ruajtjen e tyre është më e madhe. Habitatet e tjerë të pranishëm janë kryesisht ato bregdetare, halofitike, duna ranore bregdetare, ligatina, pyje, etj. Zona e grykëderdhjes së lumit Vjosa përmban habitatet më të bukura e të ruajtura të dunave ranore me Amofilë të ranishteve (*Amophylla arenaria*) në të gjithë vendin, të cilat ngrihen deri në 5 metër lartësi dhe formojnë peizazhe mahnitëse.

KULTURA LOKALE

Kompleksi Natyror Nartë-Pishë-Poro është i pasur me vlera kulturore. Në brendësi të këtij kompleksi gjenden 11 fshatra me një popullsi totale prej rreth 8000 banorë, duke përfshirë komunitetet minoritare greke. Të ardhurat kryesore për banorët lokal gjenerohen nga përdorimi i burimeve natyrore, ku përfshihen shërbimet dhe infrastrukturat e turizmit, bujqësia, pastoralizmi, peshkimi, prodhimi i kripës, etj.





Funded by the
European Union

*Kjo fletëpalosje është financuar nga Bashkimi Evropian.
Bashkimi Evropian nuk është përgjegjës për përmbajtjen
e këtij publikimi.*